



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 1135/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog, për Rivotim për Kryetarë të Komunës së Istogut të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më datë 17.12.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 19.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa ZL.Anr.1135/2017, e datës 18.12.2017 e parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me seli në Prishtinë, dega në Istog.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.12.2017 ka pranuar ankesën ZL.Anr.1135/2017 të dorëzuar, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Istog, në të cilën pretendon se në fshatin Banjë e Pejës në vendvotimin 0608C/02D, simpatizantët e LDK-së kanë treguar hapur preferencat për kandidatin e LDK-së të njëjtit nuk janë futur fare në kabinat e votimit, por haptazi kanë votuar kandidatin e LDK-së. Andaj ka kërkuar që të rinumërohet vendvotimi i cekur më lartë.

Parashtruesi i ankesë për të vërtetuar pretendimet e tij ka bashkangjitur një koment të Organizatës Joqeveritare Demokracia në Veprim, e postuar në portalin e Gazetës Express.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë pretendimeve ankimore si dhe shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore gjeti se parashtruesi i ankesës nuk i ka provuar me prova pretendimet e tij se ka pasur votim publik në Vendvotimin 0608C/02D. Prandaj, Paneli ankesën e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse pretendimet e paraqitura në ankesë i cilëson i të pabazuar. Komentet e mediave nuk paraqesin referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor të ankuesit e as bazë ligjore për rinumërim të vendvotimeve të lartcekura.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.1135/2017 më datën 19.12.2017



Udhëzim Juridike:

Në bazë të nenit 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*